

**Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus + për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Hacettepe në Turqi, për vitin akademik 2019-2020.**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Hacettepe, në Turqi në kuadër të programit Erasmus +, për stafin akademik me kohë të plotë të UT-së për mësimdhënie, për vitin akademik 2019-2020.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

**Kohëzgjatja e bursave:**

-Stafi akademik për mësimdhënie (5 ditë + 2 ditët e udhëtimit);

**Fushat e mësimdhënies:**

-Gjuhë angleze;

Për më shumë informacion, referohuni linkut:

<https://www.hacettepe.edu.tr/english/>

**Bursat përfshijnë:**

-Kompensim ditor (140 EUR për stafin akademik);

-Kostot e udhëtimit (275 EUR);

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie:**

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Vetëdeklarim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, ku);

- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Mobility\\_Agreement\\_Teaching\\_outgoing.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing.docx)

\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

**Afati për aplikim: 4 Nëntor 2019**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!